



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1162/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI66/17

Parashtrues

Ramadan Shishani dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së disa vendimeve individuale
të Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga (a) Ramadan Shishani, (b) Halil Fetahu, (c) Jakup Ibriqi, (d) Maliqe Mjeku, (e) Rrustem Berisha, (f) Nexhat Lahu, (g) Afrim Beka, (h) Besim Sylejmani, (i) Sami Shehu, dhe (j) Zeqir Behrami, të gjithë ish-punonjës të Ndërmarrjes Shoqërore (në tekstin e mëtejme: NSH)

“Ekonomia e Pyjeve” (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga Gani Asllani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë disa vendime individuale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) pasi ato ndikojnë në çdo parashtrues të kërkesës: Parashtruesi i kërkesës (a) konteston dy vendime [nr. 10876 të 14 tetorit 2013 dhe nr. 12/74 të 5 nëntorit 2013]; Parashtruesi (b) konteston një vendim [nr. 748 të 24 janarit 2014]; Parashtruesi (c) konteston dy vendime [nr. 6518, të 16 gushtit 2013 dhe nr. 6521, të 16 gushtit 2013]; Parashtruesi i kërkesës (d) konteston dy vendime, [nr. 6515 të 16 gushtit 2013 dhe nr. 6520 të 16 gushtit 2013]; Parashtruesi i kërkesës (e) konteston një vendim [nr. 6526 të 16 gushtit 2013]; Parashtruesi i kërkesës (f) dy vendime [nr. 0517, të 16 gushtit 2013 dhe nr. 6523, të 16 gushtit 2013]; Parashtruesi i kërkesës (g) dy vendime [nr. 10878 të 14 tetorit 2013 dhe nr. 6512 të 16 gushtit 2013]; Parashtruesi i kërkesës (h) konteston dy vendime [nr. 6513 të 16 gushtit 2013 dhe nr. 6524 të 16 gushtit 2013]; Parashtruesi i kërkesës (i) konteston dy vendime [nr. 6525 të 16 gushtit 2013 dhe nr. 10877 të 14 tetorit 2013]; dhe Parashtruesi i kërkesës (j) konteston dy vendime [nr. 6514 të 16 gushtit 2013 dhe nr. 6522, të 16 gushtit 2013].

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura të AKP-së, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 qershor 2017, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Artta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 4 korrik 2017, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës AKP-së.

8. Më 23 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.
9. Gjyqtari Altay Suroy votoi kundër propozimit të gjyqtarit raportues.

Përmbledhja e fakteve

10. Të gjithë parashtruesit e kërkesës ishin punonjës të NSH "Ekonomia e Pyjeve Prishtinë".
11. Më 20 janar 2011, Bordi i AKP-së mori vendimin për likuidimin e NSH "Ekonomia e Pyjeve Prishtinë".
12. Në vitin 2011, të gjithë parashtruesit e kërkesës paraqitën individualisht kërkesa në AKP, duke kërkuar pagesën e të ardhurave personale të papaguara për periudhën janar 2003 deri në dhjetor 2010.
13. Gjatë vitit 2013 dhe 2014, AKP-ja mori vendime individuale në lidhje me secilën prej kërkesave të parashtruesve. Me këto vendime, AKP-ja në mënyrë individuale njohu të drejtën e secilit prej parashtruesve në pagesën e të ardhurave personale të papaguara dhe përcaktoi shumat specifike të të hollave për secilin parashtrues të kërkesës sipas dëshmive financiare nga dokumentacioni dhe përvoja e tyre individuale të punës.
14. Në këto vendime, AKP-ja, gjithashtu njohu të drejtën që secilit parashtrues individualisht t'i paguhej një shumë si kompensim. Kjo shumë ishte e barabartë me të ardhurat e tyre personale për 3 muaj për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Në secilin nga vendimet e AKP-së thuhej që:

"Gjatë vendosjes për kërkesën tuaj, autoriteti i likuidimit ka gjetur se ju gëzoni të drejtën e pagave të papaguara, sepse pagat tuaja kanë mbetur të papaguara gjatë punës tuaj me NSH "Ekonomia e Pyjeve Prishtinë" për periudhën janar 2003 deri në dhjetor 2010 dhe një përfundim i tillë mbështetet nga provat financiare në arkivin e NSH-së".
15. Vendimet e AKP-së përfshinin një shpjegim për shpërndarjen e shumave të miratuara për parashtruesit e kërkesës, ku specifikohet që:

"Kërkesat do të plotësohen sipas prioritetit të kategorisë të përcaktuar me nenin 40. Paguesa për plotësimin e kërkesave do të kryhet në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 41 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe do të pasojnë procedurat e Autoritetit të Likuidimit në përputhje me politikat financiare të Agjencisë të nxjerra në pajtim me nenin 19 të Ligjit të AKP-së".
16. Më 2 nëntor 2016, parashtruesit e kërkesës i janë drejtuar AKP-së me kërkesë për sqarimin e vonesave në pagesën e të drejtave të tyre. Ata, gjithashtu, kërkuan pagesën e menjëhershme të të ardhurave të papaguara personale të tyre në të cilat ata kishin fituar të drejtën në pajtim me vendimet e AKP-së.

17. Më 7 nëntor 2016, AKP iu përgjigj kërkesave të parashtruesve. Secila prej përgjigjeve të AKP-së ishte bazuar në Ligjin nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe deklaroi se:

“Lidhur me kërkesën tuaj për vonesën e shpërndarjes së mëtejshme të mjeteve, ju informojmë se deri më tani, Autoriteti i Likuidimit (AL) ka përfunduar procedimin dhe lëshimin e vendimeve për të gjitha kërkesat e dorëzuara për NSH “Ekonomia Pujore Prishtinë” (në likuidim) .

Parashtruesit e kërkesës të cilët ishin të pakënaqur me vendimet e AL (në rastet kur vendimet ishin pjesërisht të aprovuara ose të refuzuara) patën mundësi të parashtronë ankesë ndaj vendimit të AL në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: DHPGJS) brenda 30 ditëve nga dita kur u ishte dorëzuar vendimi nga ana e AL.

Nga sa më sipër, për ankesat e dorëzuara në DHPGJS nga palët e pakënaqura me vendimet e Autoritetit të Likuidimit duhet të merret vendimi përfundimtar nga DHPGJS, me qëllim që të vazhdohet me shpërndarjen e pagesave edhe për kreditorët e Ndërmarrjes Shoqërore. Deri më sot, DHPGJS-ja ende nuk i ka konfirmuar plotësisht Autoritetit të Likuidimit listën e plotë të ankesave të dorëzuara në DHPGJS në lidhje me vendimet e marra.

Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore "Ekonomi e Pyjeve Prishtinë" (në likuidim), me qëllim të përgatitjes së raportit të shpërndarjes, duhet të vlerësojë (i) situatën pas shitjes së asetëve nga të cilat do të gjenerohen të ardhurat , si dhe (ii) marrjen e konfirmimit të listës me informacione të plota të ankesave nga DHPGJS.

Prandaj, nga të lartcekurat, aktualisht nuk mund të përcaktohet koha e saktë e shpërndarjes, për shkak të varësisë së çështjes nga faktorët e përmendur më lart, por AKP-ja dëshiron të [ju] sigurojë se AKP-ja po e trajton këtë çështje me përkushtim.”

18. Më 12 prill 2017, parashtruesit e kërkesës përsëri iu drejtuan AKP-së dhe Autoritetit të Likuidimit me kërkesë që t'u paguhen të ardhurat e tyre personale, në pajtim me vendimet e AKP-së.
19. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se deri në datën e dorëzimit të kërkesës së tyre në Gjykatë, ata nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga AKP-ja lidhur me kërkesën e tyre të 12 prillit 2017.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është shkelur “e drejta e tyre në pronë, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës nga AKP-ja, sepse AKP-ja është duke vonuar pagesën e shumave që u janë miratuar parashtruesve të kërkesës nga të ardhurat e likuidimit të NSH-së ku ata ishin të punësuar më parë”.

21. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, *“pagat të cilat kërkesit-punëtorë të NSH “Ekonomia e Pyjeve Prishtinë” ... me djersën e tyre është pronë e tyre, madje edhe për mbijetesë të tyre dhe familjeve të tyre, ndërsa Autoriteti i Likuidimit [AKP] sillet si zot i kësaj pasurie pa iu dhënë përgjigje punëtorëve, dhe pa arsye mban në disponim dhe shfrytëzim pasurinë e të tjerëve.”*
22. Ankesa e parashtruesve lidhet ekskluzivisht me dështimin e AKP-së për të paguar shumat që u janë miratuar atyre. Parashtruesit e kërkesës tregojnë se vendimet e AKP-së lidhur me pagat e tyre të papaguara dhe kompensimin për përfundimin e parakohshëm të punësimit të tyre ishin në favor të tyre. Prandaj, parashtruesit nuk ishin të pakënaqur dhe nuk kishin asnjë arsye për të parashtruar ankesa të mëtejshme pranë DHPGJS-së lidhur me këtë çështje. Kjo situatë ka vazhduar që kur këto vendime janë marrë në periudhën 2013-2014.
23. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se, *“është shkelur neni 49 i Kushtetutës, me të cilin e drejta e punës është e garantuar, automatikisht nga kjo rrjedhë se duhet të jetë i garantuar edhe rezultati i punës , si në rastin konkret – pagat e punëtorëve.”*
24. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata *“që ta urdhërojë AKP-në (Autoriteti i Likuidimit) t’ua paguajë pagat e papaguara të gjithëve [parashtruesve të kërkesës] sipas aktvendimeve të AKP-së, me të cilat janë miratuar kërkesat për pagat e papaguara, secilit veç e veç, në lartësinë e shumave si në aktvendime, si dhe nga tri (3) paga të miratuara, gjithashtu me aktvendime, për ndërprerje të parakohshme të punës.”*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se,

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
27. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë individë që pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga një autoritet publik dhe prandaj ata

janë palë të autorizuar për të parashtruar kërkesë sipas nenit 113 (7) të Kushtetutës.

28. Sa i përket shterimit së mjeteve juridike, Gjykata vëren se ankesa e parashtruesve të kërkesës ka të bëjë vetëm me vonesat në ekzekutimin e vendimeve të AKP-së, me të cilat u është njohur secilit prej tyre e drejta në paga të papaguara dhe kompensim. Parashtruesit e kërkesës dy herë i dërguan letra AKP-së, duke kërkuar realizimin e të drejtave të tyre.
29. Gjykata vëren se AKP-ja e pranon përgjegjësinë për realizimin e të drejtave të parashtruesve të kërkesës, por pretendon se zbatimi duhet të shtyhet me procedura pranë DHPGJS-se gjatë gjykimit të pretendimeve të palëve të tjera. Gjykata vlerëson se AKP-ja bazon qëndrimin e saj në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
30. Gjykata konsideron se implementimi i pagesave të kërkesave të parashtruesit për paga të papaguara është rezultat i një situatë të vazhdueshme.
31. As parashtruesit e as AKP-ja nuk i janë referuar ndonjë mjeti juridik që mund të jenë në dispozicion të parashtruesve të kërkesës për të zbatuar ekzekutimin e menjëhershëm nga AKP-ja të vendimeve me të cilat u njihet parashtruesve të kërkesës e drejta në paga të papaguara dhe kompensim.
32. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se vonesat në realizimin e të drejtave të parashtruesve të kërkesës janë rezultat i procedurave gjyqësore të bazuara në ligj ndaj të cilave nuk ka mjet juridik në dispozicion.
33. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
34. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton se:
“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”
35. Gjykata rikujton se kriteri për parashtrimin e kërkesës brenda afatit prej 4 (katër) muajve nuk zbatohet në rastet e shkeljes së pretenduar të vazhdueshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih: Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), Aktgjykimi i 19 marsit 1997, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, paragrafët 34-37; dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI50/12 parashtrues i kërkesës, *Agush Lolluni*, Aktgjykim i 20 korrikut 2012).
36. Në rastin konkret, Gjykata vëren se të gjitha vendimet me të cilat u njihen të drejtat e parashtruesve në pagat e papaguara dhe kompensim janë të vitit 2013.2014. Megjithatë, pagesa e këtyre shumave ndaj parashtruesve të

kërkesës është ende në pritje të veprimeve të mëtejme nga AKP-ja, për shkak të procedurave të vazhdueshme ligjore pranë DHPGJS-së.

37. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se vonesa në zbatimin e të drejtave të parashtruesve të kërkesës është rezultat i një situatë të vazhdueshme.
38. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk duhet t'i përmbahen afatit kohor prej 4 (katër) muajve kur e parashtrojnë kërkesën e tyre, ashtu siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
39. Në përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe kanë parashtruar kërkesën e tyre brenda afatit ligjor.
40. Gjykata më tej i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

41. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre në pronë dhe të drejtën e tyre të punës, të mbrojtura me nenet 46 dhe 49 të Kushtetutës. Parashtruesit pretendojnë se kjo shkelje e të drejtave të tyre është rezultat i vonesave në pagesën e shumave për pagat e papaguara dhe kompensimin që u është dhënë atyre. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kjo vonesë e realizimit të të drejtave të tyre është shkaktuar nga AKP-ja, e cila është një autoritet publik i themeluar me ligj.
42. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë qartësuar saktësisht se cilat të drejta pretendojnë se u janë shkelur dhe cilin akt të autoritetit publik ata kontestojnë.
43. Megjithatë, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh që,

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

44. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se AKP-ja, duke vonuar zbatimin e vendimeve me të cilat ishte aprovuar pagesa e pagave të papaguara dhe kompensimi për ndërprerjen e parakohshme të punësimit të

tyre, ka shkelur të drejtën e tyre për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës.

45. Gjkata rikujton që neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës parasheh, *inter alia*, se:

“1. E drejta e pronës është e garantuar.”

46. Gjkata konsideron se e drejta e parashtruesve për pagesën e shumave që u janë dhënë atyre me vendimet e AKP-së janë brenda fushëveprimit të konceptit të pronës, të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës.
47. Gjkata vëren se të drejtat e parashtruesve për shumat e dhëna nuk janë në kontest ndërmjet parashtruesve dhe AKP-së.
48. Gjkata vëren më tej se AKP-ja ka sqaruar se pagesa e shumave të dhëna është në pritje të përfundimit të vendimeve gjyqësore nga DHPGJS-ja lidhur me pretendimet e tjera mbi pasuritë e NSH-së në likuidim. Gjkata vëren se AKP-ja ka bazuar qëndrimin e saj në Ligjin nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
49. Për më tepër, Gjkata vëren se vendimet për dhënien e shumave parashtruesve të kërkesës përmbanin një sqarim lidhur me shpërndarjen e shumave. Në këtë sqarim theksohej se:

“Kërkesat do të plotësohen sipas prioritetit të kategorisë të përcaktuar me nenin 40. PAGESA PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE DO TË KRYHET NË PAJTIM ME PARAGRAFËT 2 DHE 3 TË NENIT 41 TË SHTOJCËS SË LIGJIT TË AKP-SË DHE DO TË PASOJË PROCEDURAT E AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT NË PËRPUTHJE ME POLITIKAT FINANCIARE TË AGJENCISË TË NJJERRA NË PAJTIM ME NENIN 19 TË LIGJIT TË AKP-SË”.

50. Bazuar në këtë sqarim për shpërndarje, Gjkata vëren se realizimi i të drejtave të parashtruesve të kërkesës është e kushtëzuar nga rrethanat e përmendura në vendime, sipas të cilave është miratuar pagesa e shumave, përkatësisht shpërndarja duhet të pasojë pas përfundimit të procedurave nga autoriteti i likuidimit. Gjkata vëren se këto procedura të likuidimit ende vazhdojnë.
51. Si rrjedhojë, Gjkata gjen se kërkesa e parashtruesit për pagesë të pagave të tij të papaguara është e parakohshme. Gjkata konsideron se parashtruesit e kërkesës kanë pasur të drejtën e pronës që është njohur nga AKP-ja. Zbatimi i kësaj të drejte në pajtim me vendimet e AKP-së do të realizohet vetëm atëherë kur të plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara në vendimet e AKP-së.
52. Në këtë drejtim, Gjkata vëren se vonesa e AKP-së në realizimin e të drejtave të parashtruesve të kërkesës bazohet në ligj.
53. Gjkata rikujton praktikën gjyqësore të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës është konstatuar se e drejta për pronë nuk humbet kur nuk plotësohet një kusht nëse ky kusht është pjesë përbërëse e së drejtës (shih:

Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut për Pranueshmëri i 5 tetorit 1978, *Mario de Napoles Pacheco kundër Belgjikës*, nr. 7775/77).

54. Duke zbatuar këtë arsyetim në rastin e tanishëm, Gjykata konsideron se realizimi i të drejtave të parashtruesve të kërkesës ishte kushtëzuar me ligjin për përfundimin e të gjitha procedurave gjyqësore pranë DHPGJS-së lidhur me shpërndarjen e aseteve të NSH-së në likuidim. Në kundërshtim me praktikën gjyqësore të lartpërmendur, në rastin e parashtruesve të kërkesës, e drejta e tyre në pronë nuk ka humbur, por ende është në pritje të zgjidhjes së kushteve ligjore.
55. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk janë shkelur të drejtat e parashtruesve në pronë si rezultat i vonesës në realizimin e të drejtave të tyre, sepse kjo vonesë është pasojë e kushteve ligjore që të gjitha procedurat ligjore pranë DHPGJS-së duhet të përfundohen para se AKP-ja të mund t'u bëjë ndonjë pagesë parashtruesve të kërkesës. Ky kusht ishte pjesë përbërëse e miratimit të pagesës dhe kompensimit, siç kërkohet me ligj.
56. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë vërtetuar pretendimin e tyre se është shkelur e drejta e tyre në pronë nga AKP-ja për shkak të vonesës në pagesën e shumave që u janë caktuar atyre.
57. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se vonesa në pagesën e shumave që u janë dhënë atyre përbën shkelje të së drejtës së tyre të punës, të mbrojtur me nenin 49 të Kushtetutës, sepse pagesa e kompensimit për punë është pjesë integrale e së drejtës së punës.
58. Gjykata rikujton se neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës, parasheh *inter alia*, që:

“1. E drejta e punës garantohet.”
59. Gjykata vëren se të drejtat e parashtruesve për pagesën e shumave të caktuara bazohen në marrëdhënien e mëparshme të punës së parashtruesve të kërkesës me NSH.
60. Përkitazi me këtë, Gjykata konsideron se vendimi i AKP-së me të cilin i jepet e drejta parashtruesve në pagat e papaguara dhe në kompensim për ndërprerjen e parakohshme të punësimit i adreson plotësisht të drejtat e parashtruesve të kërkesës në punë.
61. Përveç kësaj, Gjykata rikujton praktikën e saj të mëparshme gjyqësore në lidhje me të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit. Gjykata konsideron se aktgjykimi i kontestuar i AKP-së në asnjë mënyrë nuk i ndalon parashtruesit e kërkesës që të punojnë ose të ushtrorjnë profesionin. Në këtë mënyrë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesve të kërkesës që do të arsyetonte përfundimin se është shkelur e drejta e tyre kushtetuese e punës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktvendim i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 34).

62. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe as nuk kanë mbështetur pretendimet e tyre për të treguar se si dhe pse AKP-ja ka shkelur të drejtat e tyre për mbrojtjen e pronës dhe të drejtën e punës siç garantohet me nenin 46 dhe nenin 49 të Kushtetutës.
63. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36, paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 tetor 2017, me shumicë votash:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

